

# **TË DREJTAT PUBLIKE TË JOMUSLIMANËVE NË VENDET ISLAME**

**Tarik el Isa**

Titulli në origjnal: **الحقوق العامة لغير المسلمين**

في بلاد المسلمين

Titulli në shqip: **Të drejtat publike  
të jomuslimanëve  
në vendet islame**

Autor: **Tarik el Isa**

Përkthyes: **Kastriot Bardhi**

Korrektimi: **Valmira Bardhi**

Botues: **Fondacioni “Mirënjohja”**

Botimi i parë: **Tiranë, 2022**

**PARATHËNIE**

**Me emrin e Allahut,  
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!**

Falënderimi i takon vetëm Allahut! Paqja, bekimet dhe mëshira e Allahut qofshin për Muhamedin صلى الله عليه وسلم, pas të cilit nuk ka më Profet tjetër, si dhe për familjen dhe gjithë shokët e tij!

Në dekadat e fundit Islami dhe muslimanët janë akuzuar për mosrespektim të jetës së njerëzve dhe dhunim të pronës së tyre. Në fakt, akuzat e tyre i kanë bazuar dhe në sjelljet devijante të grupeve të dhunshme ekstremiste, që pretendojnë se përfaqësojnë Islamin, si p.sh. ISIS-i (i ashtuquajhuri “Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë”) etj.

Në faqet vijuese do ta shohësh se Islami jo vetëm që promovon të drejtat e njeriut, por ka qenë

mbrojtës i tyre shumë shekuj para ratifikimit të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. Allahu i Lartësuar ka thënë:

(وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ)

**“Ne të dërguam ty (o Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha botët.”** (El Enbija: 107)

Do të thotë se Allahu e dërgoi Profetin e Tij صلى الله عليه وسلم si mëshirë për çdo gjë që ekziston.

Në gjuhën arabe, jomuslimanët që banojnë në shtetin islam quhen *“ehlu edh-dhimeti”*. Ndërmjet tyre dhe shtetit islam ekziston një marrëveshje sigurie, nëpërmjet së cilës u garantohen të drejtat publike dhe private, sikurse u garantohen edhe muslimanëve.

Ndërsa jomuslimanët që hyjnë në shtetin islam si vizitorë apo me kontratë pune e banim të përkohshëm, këta në gjuhën arabe quhen “*mua’hadune*”. Edhe këtyre u garantohen të gjitha të drejtat e lartpërmendura.

Islami erdhi si dritë e shpëtim për botën, në kohën kur atë e kishte kapluar injoranca dhe errësira. Islami është fe universale. Profeti i Islamit صلى الله عليه وسلم është dërguar për mbarë njerëzimin, pa dallim ngjyre, race dhe etnie.

Nuk ka ndonjë fe apo legjislacion në botë më të mirë për njeriun sesa Islami! Askush si Islami nuk i garanton njeriut të drejtat e tij! Askush nuk detyrohet të pranojë Islamin me dhunë dhe as të braktisë fenë e tij.

**Tarik el Isa**

# **Të drejtat publike të jomuslimanëve në vendet islame**

Mësimet e Islamit, vlerat dhe parimet e tij, janë në pedestal dhe qëndrojnë mbi të gjitha vlerat dhe parimet që ka vendosur njerëzimi për veten. Sepse kjo fe madhështore është shpallje nga ana e një të Urti të Gjithëdijshtëm. Allahu i Lartësuar thotë:

(أَلَا يَعْلَمُ مَنْ خَلَقَ وَهُوَ اللَّطِيفُ الْخَبِيرُ)

**“E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka,  
kur Ai di në imtësi çdo të fshehtë?!”**

(El Mulk: 14)

Sigurisht që Islami është një fe plot mëshirë e drejtësi për të gjithë, për muslimanët dhe

jomuslimanët. Madhështia e sheriatit islam shprehet qartë edhe në faktin se ai përcaktoi rregullat, kriteret dhe të drejtat në marrëdhëniet e njerëzve me njëri-tjetrin. Asnjë fe apo legjislacion mbi faqen e dheut nuk i ka vendosur të drejtat e ndërsjella mes njerëzve ashtu si Islami!

Këto janë disa nga të drejtat që Islami ua garanton jomuslimanëve, që jetojnë në vendet islame:

1. E drejta për të ruajtur dinjitetin njerëzor.
2. E drejta e lirisë së besimit.
3. E drejta për të praktikuar fenë e tyre.
4. Drejtësi e barazi para ligjit.
5. E drejta për të ruajtur gjakun, pasurinë dhe nderin, si dhe e drejta për t'u mbrojtur nga sulmet.

6. E drejta për trajtim të mirë dhe solidaritet social.

# 1. E drejta për të ruajtur dinjitetin njerëzor

Islami vendosi ligjet dhe rregullat më të mira për të ruajtur dinjitetin njerëzor 14 shekuj përpara se Kombet e Bashkuara të ratifikonin Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.

Ju ftoj të përsiatni ajetet kuranore dhe hadithet profetike, për të parë se si Allahu e ngriti statusin e njeriut deri në atë pikë sa i urdhëroi engjëjt të përuleshin në sexhde para tij. I Lartësuar thotë:

(وَإِذْ قُلْنَا لِلْمَلَائِكَةِ اسْجُدُوا لِآدَمَ فَسَجَدُوا إِلَّا إِبْلِيسَ أَبَىٰ)

**“Kur u thamë engjëjve: “Përuluni në sexhde para Ademit”, të gjithë u përulën, përveç Iblisit, i cili refuzoi.”** (Ta Ha: 117)

Pastaj Allahu i Lartësuar, me Bujarinë e Tij, e nderoi këtë njeri në mënyrë të veçantë. I Lartësuar thotë:

وَلَقَدْ كَرَّمْنَا بَنِي آدَمَ وَحَمَلْنَا هُمْ فِي الْبَرِّ وَالْبَحْرِ وَرَزَقْنَاهُمْ مِنَ  
الطَّيِّبَاتِ وَفَضَّلْنَاهُمْ عَلَى كَثِيرٍ مِمَّنْ خَلَقْنَا تَفْضِيلًا

**“Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar pasardhsit e Ademit: ua kemi bërë të mundur që të udhëtojnë në tokë dhe në det, i begatuam me ushqime të mira dhe i kemi ngritur lart mbi shumë prej krijesave që Ne kemi krijuar.”** (El Isra: 70)

I nderoi njerëzit me dituri dhe arsye, dërgoi tek ata profetë dhe u zbriti libra, zgjodhi më të mirët e më të drejtët prej tyre, u dhuroi mirësi të dukshme e të padukshme, si dhe i krijoi ata në formën më të bukur. I Lartësuari thotë:

(يَا أَيُّهَا الْإِنْسَانُ مَا غَرَّكَ بِرَبِّكَ الْكَرِيمِ الَّذِي خَلَقَكَ فَسَوَّاكَ فَعَدَلَكَ  
فِي أَيِّ صُورَةٍ مَا شَاءَ رَكَّبَكَ)

**“O njeri! Ç’ të mashtroi ty, që nuk i besove Zotit tënd Bujar, Cili të krijoi, të përsosi dhe**

**të harmonizoi, si dhe të dha formën që Ai dëshiroi?!” (El Infitar: 6–8)**

Allahu derdhi mbi njerëzit bekime të bollshme.

I Lartësuari thotë:

(وَأَتَاكُمْ مِنْ كُلِّ مَا سَأَلْتُمُوهُ<sup>ج</sup> وَإِنْ تَعُدُّوا نِعْمَتَ اللَّهِ لَا تَحْصُوهَا<sup>ظ</sup> إِنَّ  
الْإِنْسَانَ لَظَلُومٌ كَفَّارٌ)

**“Ai ju jep nga gjithçka që i kërkon. Edhe nëse përpiqeni t’i numëroni të mirat e Allahut, nuk do të mund të arrini t’i numëroni ato. Vërtet, njeriu është i padrejtë dhe shumë mosmirënjohës.” (Ibrahim: 34)**

Gjithashtu i Lartësuari thotë:

(يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا  
زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً<sup>ج</sup> وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ  
بِهِ وَالْأَرْحَامَ<sup>ج</sup> إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا)

**“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu të vetëm, ndërsa prej tij krijoi bashkëshorten e prej atyre të dyve krijoi shumë burra e gra. Frikësojuni**

**Allahut, me emrin e të Cilit përбетoheni dhe ruajini lidhjet farefisnore! Vërtet, Allahu është Mbikëqyrësi juaj i përhershëm.”**

(En-Nisa: 1)

I Dërguari i Allahut ﷺ më shumë se 14 shekuj më parë shpalli një pakt për njerëzimin, që askush nuk i kishte paraprirë, atëhere kur ai ﷺ tha:

*“O ju njerëz! Me të vërtetë, Zoti juaj është Një! Babai juaj është një! Nuk ka dallim mes arabit dhe joarabit e as ndërmjet joarabit dhe arabit. Sikurse, nuk ka dallim mes të kuqit dhe të ziut e as ndërmjet të ziut dhe të kuqit. Dallimi ndërmjet tyre është vetëm në devotshmëri. A është i qartë mesazhi që ju përçolla? Sahabët thanë: ‘Po, o i*

Dërguar i Allahut ﷺ, ne dëshmojmë se ti e përçolle qartësisht mesazhin tënd.’

– *Çfarë ditë është kjo?*

- Është ditë e shenjtë.
- *Çfarë muaji është ky?*
- Është muaj i shenjtë.
- *Çfarë vendi është ky?*
- Është vend i shenjtë.

Pastaj Profeti صلى الله عليه وسلم tha: *“Padyschim që Allahu e ka bërë të shenjtë ndërmjet jush gjakun, pasurinë dhe nderin tuaj* (këtu dyshon transmetuesi i hadithit, shpreh pasiguri: nëse ka thënë apo jo “nderin tuaj”), *sikurse e ka shenjtëruar këtë ditë, këtë muaj dhe këtë vend.*

*A është i qartë mesazhi që ju përcolla?*

Sahabët thanë: ‘Po, o i Dërguar i Allahut, dëshmojmë se e përcolle qartësisht mesazhin tënd.’

Profeti صلى الله عليه وسلم tha: *“Atëherë ai që e dëgjoji këtë mesazh le tia përcjellë atij që nuk ishte prezent!”*

(Buhariu, nr. 13; Muslimi, nr. 45; hadithin e përcjell Enesi رضي الله عنه)

Kurani i madhërishëm nxit diskutimin me jomuslimanët dhe këshillon që kjo të realizohet me mënyrën më të mirë e më të bukur.

Allahu i Lartësuar thotë:

وَلَا تُجَادِلُوا أَهْلَ الْكِتَابِ إِلَّا بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ إِلَّا الَّذِينَ ظَلَمُوا مِنْهُمْ ۖ وَقُولُوا آمَنَّا بِالَّذِي أُنزِلَ إِلَيْنَا وَأُنزِلَ إِلَيْكُمْ وَإِلَهُنَا وَإِلَهُكُمْ وَاحِدٌ وَنَحْنُ لَهُ مُسْلِمُونَ

**“Diskutoni me ithtarët e Librit vetëm me mënyrën më të mirë, por jo me ata që janë të padrejtë. Dhe thoni: “Ne i besojmë shpalljes që na është zbritur neve dhe shpalljes që ju zbriti juve. Zoti ynë dhe Zoti juaj është Një dhe ne vetëm Atij i jemi dorëzuar.” (El Ankebut: 46)**

Islami ua ndalon ndjekësve të tij përbuzjen e besimeve të tjerëve, nënçmimin e librave të tyre dhe ofendimin e zotave të tyre. I Lartësuari thotë:

(وَلَقَدْ اسْتَهْزَأَ بِرُسُلٍ مِنْ قَبْلِكَ فَحَاقَ بِالَّذِينَ سَخِرُوا مِنْهُمْ مَا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِئُونَ)

**“Me të vërtetë, janë përqeshur shumë të dërguar para teje. Por mbi ata që përqeshën (profetët) u bë realitet ai (dënimi i Zotit) me të cilin talleshin.”** (El Ena’m: 10)

El Kermani ka thënë: “Allahu na urdhëron që t’i besojmë gjithë librave që u janë shpallur profetëve.”

Prandaj muslimanët i nderojnë gjithë profetët. Profeti صلى الله عليه وسلم ka thënë në një hadith shumë të njohur: **“Të besosh në Allahun, në engjëjt e Tij, në librat e tij dhe në të dërguarit e Tij...”** (Buhariu, hadithin e përcjell Ebu Hurejre رضي الله عنه)

**Profeti ﷺ i lavdëron të dërguarit e Allahut.**

Në shumë hadithe, Profeti ﷺ i lavdëron profetët e tjerë, që janë dërguar para tij.

**Ndër shembujt më të mirë të respektit të muslimanëve për jomuslimanët janë këto në vijim.**

- Profeti ﷺ u ngrit në këmbë, kur kaloi pranë tij xhenazeja e një hebreu. I thanë: “Ai ishte një hebre.”

Profeti u ﷺ tha: ***“A nuk është njeri?!”*** (Buhariu 2/86–87)

- El Musteurid el Kureshij u tregonte njerëzve se kishte dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ se kishte thënë: ***“Kur të bëhet Kiameti romakët do të jenë shumica e njerëzve.”*** Kur dëgjoji këto fjalë, Amr bin el Asi i tha: “Shiko se çfarë po thua!” Musteuridi iu përgjigj: “Po them atë që kam dëgjuar nga i

Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم!” Atëherë Amri i tha: “Nëse po thua këtë, atëherë tek ata gjenden katër virtyte:

- ata janë njerëzit më të vetëpërmbajtur gjatë provës,
- më të shpejtët në rimëkëmbje pas fatkeqësisë,
- të parët në revansh pas humbjes,
- dhe më të mirët ndaj të vobektit, jetimit dhe të dobët.
- Dhe e pesta, një e mirë e bukur: ndaluesit më të mëdhenj të padrejtësisë së mbretërve.” (Muslimi nr. 2898)

## 2. E drejta e lirisë së besimit

- Allahu i Lartësuar thotë:

(لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ ۖ قَدْ تَبَيَّنَ الرُّشْدُ مِنَ الْغَيِّ ۚ فَمَنْ يَكْفُرْ بِالطَّاغُوتِ وَيُؤْمِنْ بِاللَّهِ فَقَدِ اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَىٰ لَا انفِصَامَ لَهَا ۗ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ)

**“Nuk ka detyrim në fe. Është sqaruar e vërteta nga e kota! Ai që mohon idhujt (dhe gjithçka që adhurohet në vend të Allahut) dhe beson në Allahun, ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë. Allahu dëgjon dhe di gjithçka.”** (El Bekare: 256)

- Gjithashtu i Lartësuari thotë:

(وَقُلِ الْحَقُّ مِنْ رَبِّكُمْ ۖ فَمَنْ شَاءَ فَلْيُؤْمِنْ وَمَنْ شَاءَ فَلْيُكْفُرْ ۗ إِنَّا أَعْتَدْنَا لِلظَّالِمِينَ نَارًا أَحَاطَ بِهِمْ سُرَادِقُهَا ۗ وَإِنْ يَسْتَعِيثُوا يُغَاثُوا بِمَاءٍ كَالْمُهْلِ يَشْوِي الْوُجُوهَ ۗ بِئْسَ الشَّرَابُ وَسَاءَتْ مُرْتَفَقًا)

**“Dhe thuaj: “E vërteta është nga Zoti juaj. Kush të dojë, le të besojë; e kush të dojë, le të mohojë”** Ne kemi përgatitur për mohuesit

**keqbërës një Zjarr, muret e të cilit do t'i rrethojnë ata nga të gjitha anët. Nëse do të kërkojnë ndihmë, do t'u jepet një ujë si bakër i shkrirë, që do t'ua përvëlojë fytyrat. Sa e tmerrshme është ajo pije! Sa vend i keq është ai (Zjarri)!” (El Kehf: 29)**

Lirinë e besimit e ka sanksionuar Allahu në Kuran. Ndërkaq, i Dërguari صلى الله عليه وسلم gjithashtu e pohoi këtë, por edhe muslimanët gjatë gjithë historisë së sundimit të tyre ua kanë garantuar me ligj këtë të drejtë jomuslimanëve.

**Disa shembuj për të drejtën e lirisë së besimit:**

- **Mbreti El Mensur Kalauani në vitin 680 (sipas kalendarit hënor) gaboi kur i detyroi forcërisht nënshtetasit jomuslimanë (*ehlu edh-dhimeti*) në Dinastinë Abasite të pranojnë Islamin. Dijetarët dhe gjykatësit u zemëruan shumë dhe e kundërshtuan**

me vendosmëri këtë vendim. Pas disa muajsh, shumica e jomuslimanëve u kthyen në fenë e tyre.

● **Ebu Bekri رضي الله عنه** i dha këtë porosi komandantit Jezid bin Ebi Sufjan, para se ta dërgonte në betejë:

“Vërtet që ti do të gjesh njerëz që pretendojnë se i janë përkushtuar Zotit (murgjër të izoluar në manastire ku bëjnë jetë askete). Lëri ata në të tyren: në pretendimin se ia kanë kushtuar jetën Zotit. Unë ju këshilloj që të bëni kujdes e të ruheni nga 10 gjëra (të ndaluara):

– mos vrisni asnjë grua, asnjë fëmijë dhe asnjë të moshuar;

- mos prisni asnjë pemë frutore dhe mos prishni asnjë ndërtesë;
  - mos shterpezoni asnjë dele apo deve, përveçse për ushqim;
  - mos i digjni dhe mos i shpërndani bletët;
  - mos vidhni plaçkën e luftës dhe mos jini frikacakë!”
- (El Mueta, i përcjellë nga Ebi Musab ez-Zuhri 1/357)

- **Marrëveshja e Umerit me banorët e Jeruzalemit (Kudsit):**

“Kjo është marrëveshja nëpërmjet së cilës robi i Zotit, Umeri (Prijës i Besimtarëve), u jep siguri banorëve të Jeruzalemit. U garanton atyre jetën, pasuritë, kishat,

kryqet, si dhe gjithçka tjetër që lidhet me jetën e tyre fetare. Ai garanton se kishat e tyre nuk do të përdoren si banesa nga muslimanët, as nuk do të prishen dhe as nuk do të çënohen sadopak. Nuk do u çënohen as kyqet dhe asgjë nga pasuritë e kishave. Ata nuk do të detyrohen të braktisin fenë e tyre dhe nuk do të dëmtohen asnjëherë. Në Jeruzalem nuk do të banojë me ta (me të krishterët) asnjë hebre.” (Tarih Et-Taberani)

Muslimanët i ruanin kishat e të krishterëve. Të krishterët i kryenin adhurimet dhe ritualet e tyre në liri e siguri të plotë.

- **Të krishterët e Shamit (Levantit) i shkruan komandantit legjendar musliman, Ebu Ebejde Amir bin el Xherah:**

*“Ju, o muslimanë, jeni më të dashur për ne se romakët, ndonëse ata i përkasin fesë sonë. Ju jeni më besnikë dhe më të mëshirshëm ndaj nesh. Ju na mbroni nga dhuna e padrejtësia dhe kujdesini më mirë për ne.”*

### **3. E drejta për të praktikuar fenë e tyre**

Islami ua njohu jomuslimanëve lirinë e praktikimit të fesë së tyre. Atyre as nuk u imponohet dhe as nuk u obligohet praktikimi i fesë islame.

Në këtë kontekst:

- Jomuslimanët përjashtohen nga dhënia e zekatit.
- Ata nuk detyrohen të marrin pjesë në xhihad bashkë me muslimanët.
- Statusi i tyre civil (martesa, divorci etj.) dhe aktet e gjendjes civile rregullohen sipas normave juridike të fesë së tyre.
- Përcaktimi i masës së dënimit për veprat penale (si vjedhja, imoraliteti etj.) bazohet në kodin penal të fesë së tyre; d.m.th. dënimi përcaktohet nga fakti se çfarë besojnë ata për një veprim a mosveprim të

caktuar, pra, nëse ky qëndrim përbën krim a kundërvajtje apo jo (gjithmonë sipas fesë së tyre).

- Jomuslimanët kanë gjykatat e tyre të posaçme, të cilave mund t'u drejtohen, nëse dëshirojnë.

Përndryshe, mund t'i drejtohen Islamit:

(فَإِنْ جَاءُوكَ فَاحْكُم بَيْنَهُمْ أَوْ أَعْرِضْ عَنْهُمْ وَإِنْ تُعْرِضْ عَنْهُمْ فَلَنْ يَضُرُّوكَ شَيْئًا وَإِنْ حَكَمْتَ فَاحْكُم بَيْنَهُم بِالْقِسْطِ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ)

**“Nëse vijnë tek ti (për ndonjë gjykim), gjyko mes tyre (me ligjin e Zotit) ose distancohu prej tyre! Nëse shmangesh prej tyre, ata nuk mund të të dëmtojnë aspak. Por nëse gjykon mes tyre, gjyko me drejtësi, sepse Allahu i do ata që gjykojnë me drejtësi.”**

(El Maide: 42)

Këtu po citoj dëshminë e njërit prej historianëve më të mëdhenj, Gostave Le Bon, i cili në librin e tij “Civilizimi arab” thotë:

*“Është fakt i pamohueshëm historik se bota nuk ka njohur  
çlirimtarë më zemërgjerë se arabët (muslimanët) dhe as  
ndonjë fe tolerante si feja e tyre.”*

## 4. Drejtësia dhe barazia para ligjit

Islami bazohet në drejtësi dhe e miraton atë si parim bazë në trajtimin e gjithë njerëzve, të muslimanëve dhe jomuslimanëve.

- Allahu i Lartësuar thotë:

(يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُونُوا قَوَّامِينَ بِالْقِسْطِ)

**“O besimtarë! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë.”** (En-Nisa: 135)

- Gjithashtu i Lartësuari thotë:

(إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُكُمْ أَنْ تُؤَدُّوا الْأَمَانَاتِ إِلَىٰ أَهْلِهَا وَإِذَا حَكَمْتُمْ بَيْنَ النَّاسِ أَنْ تَحْكُمُوا بِالْعَدْلِ)

**“Allahu ju urdhëron që amanetet t’ua ktheni atyre që u përkasin dhe, kur të gjykoni midis njerëzve, të gjykoni me drejtësi.”**

(En-Nisa: 58)

- Sikurse thotë:

(وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَاٰنُ قَوْمٍ عَلَىٰ ۤأَلَّا تَعْدِلُوۡا ۗ اَعْدِلُوۡا هُوَ اَقْرَبُ لِلتَّقْوٰى ۗ)

**“Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj të tjerëve e t’i shmangeni drejtësisë! Jini të drejtë, sepse kjo është më afër devotshmërisë, dhe frikësojuni Allahut!”** (El Maide: 8)

Fakti që muslimani dënohet për vjedhje, nëse vjedh pasurinë e jomuslimanit, njësoj siç dënohet jomuslimani, nëse vjedh, kjo është shprehje e drejtësisë së Islamit.

Gjithashtu muslimani dënohet penalisht, nëse akuzon padrejtësisht për imoralitet ndonjë burrë a grua prej jomuslimanëve – nënshtetas të vendit islam (*ehlu edh-dhimeti*).

Ruajtja e jetës së jomuslimanëve, e pasurisë dhe e nderit të tyre, si dhe mbrojtja e tyre nga sulmet, të gjitha këto mishërojnë në vetvete parimin e drejtësisë mbi të cilin bazohet sheriatu islam.

I Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم ka thënë: ***“Kush vret një jomusliman (mua’hid – me të cilin shteti islam ka aq sigurie e paqe), nuk do ta ndjejë aromën e Xhenetit, ndonëse aroma e tij (Xhenetit) ndihet në një largësi prej 40 vitesh.”*** (Buhariu)

Gjithashtu ai صلى الله عليه وسلم ka thënë: ***“Në Ditën e Gjykimit unë do të jem kundërshtar i kujt do që i bën padrejtësi jomuslimanit (mua’hid – me të cilin shteti islam ka aq sigurie e paqe) apo e përbuz atë, apo e ngarkon me punë përtej mundësive, apo i merr atij diçka me pahir.”*** (Ebu Daudi)

Ebu Ubejde përcjell në librin “El Emual” se kur Umer bin el Hatabi رضي الله عنه gjeti një hebre që lypte në rrugë, i tha: “Ty nuk të kemi dhënë hakun që të takon. Më vjen keq që të paskemi katandisur kështu! Kur ishe i ri, ne të morëm xhizjen (taksë). Ndërsa sot në

pleqëri, të lamë pas dore.” Pastaj i caktoi asistencë sociale nga arka e shtetit, e mjaftueshme për një jetë normale.

## **5. E drejta për të ruajtur gjakun, pasurinë dhe nderin e tyre, si dhe e drejta për t'u mbrojtur nga sulmet**

Jeta është dhuratë prej Allahut dhe ajo është e garantuar për të gjithë: për individët dhe shoqëritë. Shteti është përgjegjës për mbrojtjen e jetës nga çdo sulm.

I Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم ka thënë: ***“Kush vret një jomusliman (mua’hid – me të cilin shteti islam ka akt sigurie e paqe), nuk do ta ndjejë aromën e Xhenetit, ndonëse aroma e tij (Xhenetit) ndihet në një largësi prej 40 vitesh.”*** (Buhariu)

Islami mori përsipër mbrojtjen e pronës private dhe publike nga të gjithë keqbërësit shumë shekuj përpara miratimit të konventave ndërkombëtare që sanksionojnë pacënueshmërinë e tyre.

Ky fakt përfshin:

- të drejtën për vetëmbrojtje dhe të drejtën e faljes; Islami mbron të drejtën e trashëgimisë edhe për jomuslimanët;
- shteti islam e ka për detyrë të mbrojë jomuslimanët, që jetojnë në tokën e tij; madje, jo vetëm t'i mbrojë, por edhe të luftojë për ta (për të drejtat e tyre) dhe për çlirimin e robërve të tyre, sepse ata kanë paguar xhizje (taksë) për këtë.

(Ibën Hazmi)

### **Qëndrime të denja:**

- Ebu Jusufi ka përmendur në librin “Haraçi” se sahabiu i nderuar, Ebu Ubejde Amir bin el Xherah, çliruesi i Shamit (Levantit) nënshkroi një marrëveshje me banorët e Shamit, sipas së cilës

shteti do t'u siguronte mbrojtje në këmbim të xhizjes (taksë), që ata do të paguanin.

Pak kohë më vonë, romakët përgatitën një ushtri të madhe, që ai nuk e kishte menduar kurrë. Më në fund, Amri vendosi që t'ua kthejë xhizjen duke pohuar: “Ne po jua kthejmë pasurinë tuaj, sepse kemi marrë vesh që kundër nesh është përgatitur një ushtri e madhe. Ju e kushtëzuat dhënien e xhizjes me sigurimin e mbrojtjes, gjë të cilën ne nuk mund ta bëjmë.”

- Qëndrimi i shejhut El Islam, Ibën Tejmije: Komandanti tatar lejoi lirin e robërve muslimanë, por Ibën Tejmije nuk ra dakort për këtë.

Ai tha: “Ne nuk kënaqemi derisa të lirosh të gjithë robërit: edhe hebrenjtë, edhe të krishterët. Ata janë njerëzit tanë,

me të cilët ne kemi marrëveshje sigurie. Kështu që lërin të lirë të gjithë robërit: muslimanët dhe jomuslimanët!” Komandanti tatar, kur pa këmbënguljen e Ibën Tejmijes, u detyrua t’i lirojë të gjithë robërit papërrjashtim.

## 6. E drejta e tyre për trajtim të mirë dhe solidaritet social

Allahu i Lartësuar thotë:

(لَا يَنْهَاكُمُ اللَّهُ عَنِ الَّذِينَ لَمْ يُقَاتِلُوكُمْ فِي الدِّينِ وَلَمْ يُخْرِجُوكُم مِّن دِيَارِكُمْ أَنْ تَبَرُّوهُمْ وَتُقْسِطُوا إِلَيْهِمْ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ)

**“Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.”** (El Mumtehine: 8)

I Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم sillej shumë mirë me fqinjët e tij jomuslimanë:

- Profeti صلى الله عليه وسلم jetonte mes jomuslimanë të cilëve u bënte mirë vazhdimisht, u jepte dhurata dhe i pranonte dhuratat e tyre. Mirëpo një grua hebreje e preu në besë: ajo i hodhi helm mishit të një deleje dhe ia dhuroi të Dërguarit të Allahut صلى الله عليه وسلم.

Profeti ﷺ i vizitonte të sëmurët, u jepte lëmoshë të varfërve dhe bashkëpunonte në tregti me jomuslimanët.

- Qytetin e Medines e vizitoi një delegacion nga të krishterët e Abisinisë, të cilin Profeti ﷺ e mirëpriti dhe e nderoi.
- Shteti e ka për detyrë t’u sigurojë ndihmë ekonomike gjithë individëve që nuk janë në gjendje të fitojnë bukën e gojës, kështu që ai shpenzon nga arka e tij për muslimanët dhe jomuslimanët.

Ebu Ubejde përcjell në librin “El Emual” se kur Umer bin el Hatabi رضي الله عنه gjeti një hebre që lypte në rrugë, i tha: “Ty nuk të kemi dhënë hakun që të takon. Më vjen keq që të paskemi katandisur kështu! Kur ishe i ri, ne të morëm xhizjen (taksë). Ndërsa sot në

pleqëri, të lamë pas dore.” Pastaj i caktoi asistencë sociale nga arka e shtetit, e mjaftueshme për një jetë normale.

## KONKLUZIONI

Këto janë të drejtat publike të jomuslimanëve të garantuara në sheriatin islam. Pas leximit të këtyre fakteve, askush nuk ka të drejtë të akuzojë muslimanët se nuk u ofrojnë të drejta jomuslimanëve. Përkundrazi, muslimanët u ofrojnë jomuslimanëve shumë më tepër nga të drejtat themelore të njeriut, sesa u jepen muslimanëve në vendet jomuslimane.

## FJALA PËRMBYLLËSE

Pasi të lexoni këto të drejta, të rrënjosura në sheriatin islam, për jomuslimanët që jetojnë në vendet muslimane, do të bindeni se Islami dhe muslimanët përfaqësojnë një fe të paqes, tolerancës dhe mëshirës për mbarë njerëzimin dhe se kjo fe nuk përbën aspak rrezik për ata që nuk besojnë në të.

**Tarik el Isa**

## PËRMBAJTJA

Parathënie.....	3
Të drejtat publike të jomuslimanëve në vendet islame.....	6
1. E drejta për të ruajtur dinjitetin njerëzor.....	9
2. E drejta e lirisë së besimit.....	18
3. E drejta për të praktikuar fenë e tyre.....	24
4. Drejtësi dhe barazi para ligjit.....	27
5. E drejta për të ruajtur gjakun, pasurinë dhe nderin, si dhe e drejta për t'u mbrojtur nga sulmet.....	31
6. E drejta e tyre për trajtim të mirë dhe solidaritet social.....	35
Konkluzioni .....	38
Fjala përmbyllëse.....	39
Përmbajtja.....	40

